

ALARM 14

KUSH RREZIKON LIRINË E MEDIAVE?!

1. KA DALLIME!



Për VMRO-DPMNE nuk ishte problem të „harxhohen“ 1 milion e 425 mijë euro vetëm për reklama në medime¹ për zgjedhjet e vitit 2014. Kurse 13 partitë tjera së bashku, për reklama në mediat kanë pasur „fuqi“ të harxhojnë 37% më pak! Menjëherë pas zgjedhjeve, mediat që kanë reklamuar VMRO-DPMNE-në kanë deklaruar se ju kanë borxh rreth 900 mijë euro.

Dhe derisa VMRO-DPMNE grumbullon borxhet, qytetarët „mbijetojnë“ me llogari të bllokuara nga përmbaruesit, kurse firma janë të ngjitura në „murrin e turpit“ të DAR-it, madje disa edhe për borxhe të vogla.

2. A BLEJNË MEDIAT DITË OSE INVESTOJNË NË ARDHMËRINË E TYRE?

Madje 70 media kanë reklamuar VMRO-DPMNE për zgjedhjet. Por, prej 1 milion e 425 mijë euro të shpenzuara, 63% ose 899 mijë euro u takojnë vetëm 7 pronarëve të mediave, edhe atë: TV Kanal 5, Media Print Makedonija, TV Alfa, TV Sitel, Nova Makedonija, TV Vis dhe Veçer.

Sipas raporteve që këto media kanë dorëzuar tek Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit, dy javë pas përfundimit të zgjedhjeve, VMRO-DPMNE ende ju ka pasur borxh 2/3 e shumës, gjegjësisht mbi 715 mijë euro.

Habit qëndrimi tolerant i mediave ndaj borxheve të VMRO-DPMNE.

VEÇER

€35.049

VIS

€24.520 €25.626

NOVA MAKEDONIJA

€23.745 €50.589

SITEL

€128.375

ALFA

€146.879

MEDIA PRINT MAKEDONIJA

€131.432 €99.809

KANAL 5

€2.450 €230.550

■ VMRO-DPMNE KA PAGUAR ■ VMRO-DPMNE KA BORXH

Në 6 vitet e fundit janë zbatuar 4 kampanja zgjedhore, prej të cilave dy kanë qenë për zgjedhje të parakohshme parlamentare, që kanë siguruar vazhdimësinë e qeverisjes së VMRO-DPMNEs.

Në shoqërinë e mediave ku shfaqen reklamat e panumërta të qeverisë dhe reklamat partiake dhe kampanjat dhe shpërndahen informata të sajura dhe sulme ndaj Fondacionit Shoqëria e hapur – Maqedoni janë TV Sitel, TV Kanal 5, TV Alfa, Radio Maqedonia e Lirë, radio-difuzuesi publik kombëtar RTM, Veçer, Dnevnik, Nova Makedonija dhe Republika. Sulmeve ndaj Fondacionit ju bashkangjiten edhe portalet Kurir.mk, Netpress.com.mk, Republika.mk, Press24.mk, Maksim.mk, Mkd.mk, Vistina.mk, eVesti.mk dhe Puls24.mk.

A do të shpall përfundimisht VMRO-DPMNE mjetet financiare publike që i ka shpenzuar për kampanjat e shumta të qeverisë në mediat që i menaxhon?

Gjithashtu, për publikun mbetet e panjohur, a kanë mbetur dhe si janë shlyer borxhet ndaj mediave gjatë viteve të kaluara?

¹ Burim: Nga raportet e medieve që i kanë dorëzuar tek Komisioni shtetëror për parandalimin e korrupsionit dhe janë në dispozicion në faqen e internetit <http://www.dksk.org.mk/>

REKLAMA PARTIAKE NË MEDIA PËR ZGJEDHJET 2014

€1.425.000
VMRO-DPMNE



€891.500
13 PARTITË TJERA

3. DHE PËRSËRI, KA DALLIM!

Fondacioni Shoqëri e Hapur - Maqedoni ka qenë dhe mbetet i brengosur për rënien e lirisë së mediave, dhe për këtë shkak 6 vite me radhë dhuron mjete dhe ndihmon disa media. Ka dallim! Dallimi është se Fondacioni ka donuar mbi 900 mijë euro, edhe atë për 6 vjet, shumë që është për 35% më e ulët nga ajo që VMRO-DPMNE ka shpenzuar vetëm për kampanjën zgjedhore në vitin 2014!

Fondacioni Shoqëri e Hapur - Maqedoni	Buxhet	Përkrahje për mediat dhe portalet
2009	€4.621.355	€39.364
2010	€4.429.545	€46.758
2011	€4.164.949	€97.875
2012	€4.827.105	€226.305
2013	€5.199.742	€393.479
2014	€3.369.696	€133.359
GJITHSEJ		€937.140

Prej vitit 2009 e deri sot, Maqedonia marramënti bie në listat që vlerësojnë lirinë e mediave. Në listën e Raportuesve pa kufij deri tani ka rënë për 82 vende kurse në listën e Freedom haus për 25 vende.

PËRDERISA MAQEDONIA MBETET SHTET PJSËRISHT I LIRË, VMRO-DPMNE VAZHDON TË REKLAMOHET.

PO, KA DALLIM!